



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
REKTORATI

Nr. 903 Prot.

Tiranë, më 24.03.2020

VENDIM QARKULLUES
NR. 7, DATË 24.03.2020

**PËR ZHVILLIMIN E PROCESIT MËSIMOR NË PLATFORMËN ONLINE NË
UNIVERSITETIN E MJEKËSISË TIRANË**

Bazuar në Ligjin nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSh", Statutit dhe rregullores së UMT, të Urdhrit nr.156, datë 10.03.2020 të Ministrit të Shëndetësisë dhe MS, në kuadër të shpalljes së gjendjes së epidemisë COVID-19, si dhe të shtyrjes së procesit mësimor në institucionet arsimore me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19, Rektorati i Universitetit të Mjekësisë Tiranë,

VENDOSI:

1. Të miratojë fillimin e procesit mësimor "online" në të gjitha programet e studimit që ofron Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, **me datë 30 mars 2020**, në përputhje me rregullat e zhvillimit të procesit mësimor. Ky proces do të realizohet nëpërmjet përdorimit të platformës Google Classroom, platformës të RASH-it "Virtual University (<https://vuni.rash.al/>) apo platformave të tjera alternative.
2. Mënyra e përdorimit të platformës Google Classroom të shoqërohet me udhëzuesin përkatës për stafin akademik dhe studentët.
3. Fakultetet të shpallin në faqen web: emërtimin e modulit/lëndës, emrin e pedagogut/pedagogëve përgjegjës dhe kodin e lëndëve në Google Classroom.
4. Dekanët e fakulteteve të UMT të marrin masa për monitorimin në vijimësi të zhvillimit të procesit mësimor online; të ngrihen grupe pune në nivel fakulteti (zv. dekani për anën mësimore, përgjegjësit e departamenteve) të cilët raportojnë në vijimësi në dekanatet përkatëse.
Çdo fakultet të raportojë në vijimësi në formë elektronike në Rektoratin e UMT-së për mbarëvajtjen e mësimit "online".
5. Afati për krijimin e lëndëve/moduleve me kodet përkatëse, sipas udhëzuesit të përdorimit është data 25 mars 2020.
6. Ngritja e grupeve të punës në nivel fakulteti (sipas pikës 3) dhe pajisja e çdo Departamenti me listat emërore të studentëve sipas viteve akademike, lëndëve, paraleleve dhe grupeve me e-mailet përkatëse (*lista të sakta me studentët frekuentues*) nga sekretaritet mësimore është data 25 mars 2020.

7. Për zhvillimin i formave të tjera të mësimdhënies, si praktika klinike, praktika mësimore, laboratorë etj, do të ketë një vendimmarrje të dytë në varësi të situatës.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ngarkohen për zbatimin e tij Zv. Rektori për anën mësimore, Dekanët dhe Zv.Dekanët, Përgjegjësit e Departamenteve, Sekretaritetë mësimore dhe IT e fakulteteve.

REKTORI

ARBEN GJATA

Në mungesë dhe me urdhër

ZV. REKTOR
Anyla KASNECI

